



Datë: 27.01.2026

Numër Protokolli: 462/2026

A.nr.1835/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1835/2025, të datës 23.10.2025, të parashtruar nga ankuesi A.A, kundër organit të punësimit: Komunës së Klinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa numër A.nr.1835/2025 e datës 23.10.2025 e parashtruar nga ankuesi A.A.

II. Detyrohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshëm administrativ në mënyrë që ankuesi të realizoj pagën sipas Akt Emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025, si dhe të procedoj kërkesë pranë Thesarit të Kosovës për kompensim retroaktiv të diferencës së paguar të pagës nga profesional 3 në profesional 2 dhe atë nga data 12.06.2025 e deri në zbatimin e këtij vendimi.

III. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës sipas pikën II të dispozitivit, të ekzekutoj të drejtën e kompensimit të pagës së ankuesit sipas Aktit të Emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025, si dhe kompensimin retroaktiv të diferencës së paguar të pagës nga profesional 3 në profesional 2 dhe atë nga data 12.06.2025 e deri në zbatim të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi A.A, (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 23.10.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për mos realizim të pagës sipas klasës së pagës të kategorisë profesionale 2 të paraparë sipas Akt Emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka përcjell kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa, kjo e fundit, ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6941/2025 të datës 23.10.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin e datës 12.06.2025 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore; Propozimin nga Komisioni i Ristrukturimit i datës 12.06.2025; Konfirmimin për transferim i datës 20.06.2025; Kërkesën e ankuesi e datës 21.10.2025; Përgjigjen e institucionit e datës 21.10.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.10.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 30.10.2025; Akt Emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025; Vendimin e datës 30.07.2024 për themelimin e komisionit për ristrukturim; Diplomën me Nr. 1611 të ankuesit; Kërkesën e datës 25.03.2025 nga M.B për XH.D; Kërkesën e datës 25.03.2025 nga XH.D për M.B; Emailin e datës 28.07.2025 nga E.M për N.M; Listën e pagave qershor, korrik, gusht, shtator 2025 për ankuesin; Formularin për ndryshime i datës 07.07.2025; Vendimin A.nr.713/2025 të KPMSHCK-së; Akt Emërimit 02 Nr.112-29645/2024 të datës 02.09.2024; Kërkesën e datës 24.04.2025 të ankuesit për XH.D dhe përgjigjen e datës 24.04.2025 nga E.M për ankuesin.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

I. Gjendja e fakteve të çështjes

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë se:

-Ankuesi është i punësuar në Komunën e Klinës dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit 02 Nr. 112-29645/2024 të datës 02.09.2024, i lëshuar si rezultat i procesit të ristrukturimit sipas Rregullores së datës 30.05.2024, për Organizimin e Brendshëm dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës, është sistemuar në pozitën e Zyrtarit të Gjendjes Civile, në kategorinë profesionale, klasa Profesionale 3 dhe më klasë dhe koeficient të pagës GJ45 (3.92).

-Ankuesi i pakënaqur me kategorizimin e pozitës së tij në profesional 3, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se sipas Katalogut të Vendeve të Punës në shërbimin civil, pozita e tij si zyrtar i Gjendjes civile kategorizuar në profesional 2.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.713/2025 të datës 09.06.2025, kishte aprovuar si të bazuar ankesën e datës 24.04.2025, ndërsa, ka detyruar Kryetarin e Komunës dhe Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës, që të ndërmarr veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesin, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

-Komisioni i Ristrukturimit në Komunën e Klinës në zbatim të Vendimit A.nr.713/2025 të datës 09.06.2025, të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2025 i ka propozuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, transferimin e ankueses në pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 2, në kategorinë profesionale 2, në të njëjtin sektor, ndërsa, me po të njëjtën datë Menaxheri i Burimeve Njerëzore ka nxjerrë Vendimin me Nr.112-174547/2025, për transferimin e ankuesit në pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 2, në kuadër të Drejtorisë për Administratë-Sektori i Gjendjes Civile, me koeficient të pagës 5.4, rrjedhimisht më datë 12.06.2025 i ka lëshuar edhe Akt Emërimit 02 Nr.112-17558/2025, për pozitën e njëjtë Zyrtar për Gjendje Civile, në kategorinë profesionale, klasa -Profesional 2, me klasë dhe koeficient të pagës GJ37 (5.4).

- Si rezultat i mos realizimit të pagës sipas Akt emërimit me Nr.112-17558/2025, të datës 12.06.2025, përkatësisht sipas koeficientit 5.4, ankuesi me datë 21.10.2025 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, përmes të cilës ka kërkuar informacion për mos zbatimin e vendimit të transferimit.

-Menaxheri i Burimeve Njerëzore me datë 21.10.2025, ka njoftuar ankuesin duke theksuar se, citoj: *“NJMBNJ-ja, lidhur me kërkesën e juaj, ju informon se bazuar në propozimin e Komisionit të Ristrukturimit juve ju ka transferuar në pozitën Zyrtare për Gjendjen Civile 2, në Drejtorinë për Administratë, me koeficient 5.4. Bazuar në vendimin e datës 12.06.2025, juve ju ka lëshuar akt emërimit e ri, me koeficient dhe klasë të pagës profesional 2. Neve me qëllim të ekzekutimit të pagës për muajin qershor sipas koeficientit të klasës së pagës profesional 2, akt emërimit, vendimin, propozimin e komisionit dhe të gjitha dokumentet e tjera i kemi proceduar në Thesar nëpërmjet zyrtarit të pagave për ekzekutim. Pse, Thesari nuk i ka ekzekutuar nuk i dijmë arsyet, njëkohësisht e ka udhëzuar që mund të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Pretendimet Ankimore

Ankues, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër lëshimit të Akt Emërimit me Nr.02/112-17558/2025 të datës 12.06.2025 nuk po bëhet zbatimi i klasës së pagës sipas këtij akti. Kërkon që ankesa të aprovohet, të obligohet Komuna e Klinës dhe Thesari të bëjë ekzekutimin e pagës sipas lartësisë së paraparë me akt emërimit e datës 12.06.2025, dhe atë në mënyrë retroaktive nga data 12.06.2025.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore thekson faktin se vendimet e Këshillit janë përfundimtare në procedurën administrative siç përcaktohet me neni 21, paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe konfirmuar edhe më praktiken gjyqësorë të Gjykatës Kushtetuese përmes aktgjykimeve në rastet nr. ko232/23 dhe ko233/23, ko171/18 dhe ko127/21, dhe duke qenë se lidhur me çështjen e klasifikimit të pozitës dhe pagës së ankuesit është vendosur në mënyrë meritore sipas vendimit të Këshillit A.nr.713/2025 të datës 09.06.2025, në atë mënyrë që pozita e ankuesit është grupuar dhe kategorizuar sipas përcaktimeve të

Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, atëherë, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e pagës sipas aktit të emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025, janë të bazuara ligjërisht, kështu që, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke detyruar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshëm administrativ në mënyrë që ankuesi të realizoj pagën sipas Akt Emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025, si dhe të procedoj kërkesë pranë Thesarit të Kosovës për kompensim retroaktiv të diferencës së paguar të pagës nga profesional 3 në profesional 2 dhe atë nga data 12.06.2025 e deri në zbatimin e këtij vendimi. Si dhe duke detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës sipas pikën II të dispozitivit, të ekzekutoj të drejtën e kompensimit të pagës së ankuesit sipas Aktit të Emërimit 02 Nr.112-17558/2025 të datës 12.06.2025, si dhe të dhjetën e kompensimit retroaktiv të diferencës së paguar të pagës nga profesional 3 në profesional 2 dhe atë nga data 12.06.2025 e deri në zbatim të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1835/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.A;
- Komunës së Klinës: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Personelit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.